



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1332/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e avokatit Mustaf Kastratit i autorizuari nga Fatos Çeku kandidat për anëtar kuvendit komunal në Pejë nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave gjatë publikimit të rezultateve të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuara ankesa e Mustaf Kastratit avokat i autorizuar nga Fatos Çeku nga rradhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Pejë.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 24.12.2013 ka pranuar një ankesë, nëpërmjet PTK-së të parashtruar në këtë postë me datën 03.12.2013 nga Mustaf Kastrati avokat i autorizuar nga Fatos Çeku kandidat për anëtar kuvendit komunal në Pejë nga rradhët e subjektit politik PDK në të cilën thekson se rezultati i publikuar përfundimtar nuk është në harmoni me numërin e votave për kandidatin e të cilat gjenden në kutitë e votimit. Parashtruesi i ankesës thekson se në QV 1725C, 1727C, 1701C, 1702C, 1704C, 1704Y, 1710C, 1711C, dhe 1712C në kutitë e votimit për kandidatin Fatos Çeku nga numëruesit janë numëruar votat dhe rezultati i nxjerrë nuk përputhet me fletëvotimet e kutive. Sipas parashtruesit të ankesës këto vota janë keqpërdorur nga komisionarët e PDK-së ashtu që në procesverbalet e numërimit votat e kandidatit në fjalë u janë përshkruar kandidatëve të tjerë brenda listës së PDK-së. Parashtruesi i ankesës kërkon që rezultati për këto qendra të votimit të anulohet se të urdhërohet rinumërimi i fletëvotimeve në QV e lartcekura për kandidatin në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova që do ti bënë të besueshme pretendimet e tilla ankimore, prandaj një ankesë e tillë është si e përgjithshme dhe e pa bazuar në prova dhe në dëshmi bindes, andaj PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1332/2013 më datën 27.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.